

## Procesverbal

Nga seanca e I-rë (konstituive) e Kuvendit Komunal të Dragashit , e mbajtur më 19.12.2017, duke filluar ora 10.00, me këtë:

### *Rend dite*

1. Dhënia e Betimit të anëtarëve të Kuvendit Komunal,
2. Dhënia e Betimit të Kryetarit të Komunës,
3. Propozimi dhe zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit,
4. Propozimi dhe zgjedhja e Nënkyetarit të Komunës së Dragashit, për komunitete.

z.Hatixha Sheh- Si delegate më e vjetër e këtij Kuvendi Komunal të Dragashit, të nderuar delegat, përfaqësues të OSCE-së, MAPL-së, OJQ-ve, përfaqësues të mediave dhe ju të zjerët prezent, ju dëshiroj mirëseardhje dhe e shpalli të hapur këtë seancë të I-rë (konstituive) të Kuvendit Komunal të Dragashit. Unë jam Hatixha Sheh dhe punoj si mami në QKMF-në "Adem Berisha" në Dragash dhe jam delegate e JGP-së, si subjekt politik. Me këtë rast, po theksoj se se ky Kuvend përbëhet nga 27 delegatë-anëtarë dhe atë 20 na komuniteti shumicë dhe 7 nga komuniteti jo shumicë, të përfaqësuar nga ana e 10 subjekteve politike të cilët kanë marr pjesë në zgjedhjet lokale më 22.10.2017 Në këtë seancë janë të pranishëm të gjithë 27 delegatët e nënshkruar në Listë dhe kemi kuorumin e miftueshëm për të vazhduar seancën. Mejkëtë rast, po theksoj se seanca ka karakter solemn dhe, për t'u lehtësuar mbarvajtja e punës së seancës, Shërbimi Profesional i Kuvendit Komunal , s' bashku me Ftesën, delegatëve u ka dërguar edhe materilin përcjellës, siç janë: Ligji për Vetëqversije Lokale, Statuti i Komunës së Dragashit, Rregulloren e Punës së KK-së Dragash, UA për themelimin dhe funksionimin e komiteteve obligative, si dhe Doracakun e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që, pra të gjithë, janë në funksion të njoftimit sa më të mirë të delegatëve me detyrat dhe obligimet e mëtejme. Po ashtu, e keni edhe tekstin e Betimit dhe vazhdojmë me punën-sipas rendit të ditës, me Ftesë... Pra, fillimisht e kemi dhënien e Betimit tonë-si delegatë, që në gjuhën shqipe do t'a lexon delegati i AKR-së z.Nexhat isufi (e të tjerët-me ngritjen në këmbë, do t'a përrërisin), ndërsa në gjuhën tonë të komunitetit josghumicë do t'a lexoj unë dhe kush është "për"...? Të gjithë.

z.Nexhat Isufi- E lexoj betimin (të cilin e keni pasur me matrial), përmes përsëritjes së fjalëve dhe ngritjes në këmbë ...

z.Hatixha Sheh- Tani e lexojmë Betimin e njejt-edhe në gjuhën tonë të komunitetit jo shumicë, që do t'a bëj unë...

Vazhdojmë me seancën dhe, pasi se ne dhamë betimin, tani kalojmë në pikën, që Betimin, para nesh, të jap edhe Kryetari i ri i Komunës së Dragashit z. Shaban Shabani.

z. Shaban Shabani- (Lexon tekstin e Betimit, si Kryetar i Komunës...)

z. Hatixha Sheh- Ju falënderoj delegatëve të KK-së dhe Kryetarit të ri të Komunës së Dragashit për betimin e dhënë dhe kërkoj që tekstin e Betimit, të nënshkruar nga secili-veq e veq, t'a dorëzoni këtu, për t'u arkivuar në Shërmimin e Kuvendit Komunal-Dragash.

Vazhdojmë me seancën e Kuvendit dhe, për të mbarvajtur puna e jonë, tani nevojitet që të zgjedhet Kryesuesi i ri i Kuvendit tonë dhe kërkoj që të jepen propozime, urdhëroni...?

z. Samidin Xheladini- Të nderuar, Kryetari i ri - i posazgjedhur, i Komunës së Dragashit në këtë pozitë ka ardhur në mënyrë jo të ndershme dhe LDK-ka mendon se është dëmtuar në mënyrë jo demokratike. Për herë të parë është dëmtuar dëshira e shumicës dhe në këtë pozitë ka ardhur e votat e komunitetit të pakicës e cila ka qenë e udhëhequr nga pushteti aktual dhe ai paralel dhe, për këtë, delegatët e LDK-së, do të lëshojnë seancën e Kuvendit, për shkak të manipulimeve gjatë procesit zgjedhor...

z. Usmen Ballxhi- Kërkoj fjalën, pas diskutimit të delegatit nga subjekti politik-LDK-ja dhe, si pjestarë i komunitetit jo shumicë se kam të drejtë, në këtë. Me sa e kuptova, me këtë konstatim trajtohem i sulmuar, si anëtar i këtij Kuvendi, por, me siguri, edhe ju të tjerët?! Kur është fjala për "pakicën", ne nuk jemi komunitet pakicë në Dragash. Më vjen rëndë që në një seancë solemne, në zgjedhjet e lira e demokratike në Dragash, që askush, si nga partitë politike, nga vëzhguesit vendor e ndërkombëtarë, e që është më me rëndësi as nga organizatorët e zgjedhjeve-KQZ-a, nuk kanë pasur vërejtje në procesin zgjedhor e tani po e dëgjojmë falimin se si "pakica e paska e zgjedhur dikend"?! Ky nuk është fjalim dekomkatik dhe, mos të them ndryshe, ky është fjalim i urrejtjes, pra fjalim i urrejtjes së kushtëzuar dhe athua "pakica" nuk ka të drejtën të votoj dhe ju kisha lutur që mos të ngjan kjo në këtë Kuvend, sepse paraqet sulm ndaj komunitetit jo shumicë dhe në procesin demokratik në Dragash i cili ishte legjitim, i hapur dhe i përkrahur nga të gjithë, dhe i kisha lutur kolegët që të largojnë nga fjalori termin "pakicë", sepse me ligje fjala është për "komunitetin jo shumicë" dhe të tillë jemi ne në Dragash, që kemi qenë ashtu edhe gjatë regjistrimit të popullësisë dhe, tek e fundit, Kryetari nuk është zgjedhur në mënyrë jo legjitime, por në mënyrë tejet legjitime në rundin e dytë të zgjedhjeve, i përkrahur nga popullata, komuniteti-shqiptarë, boshnjakë, goranë e tj. Dhe e gjithë kjo ishte demokratike. spese Kryetari ynë i Komunës është i zgjedhur në mënyrë tejet legjitime dhe i përkrahur edhe nga ana e KQZ-së dhe pa kurrfar vërejtje.

z.Hatixha Sheh- Vazhdojmë me seancën dhe a kemi propozime për Kryesues të Kuvendit...?

z.Elira Sulejmani-Krasniqi-Të nderuar, në emër të PDK-së, për Kryesues të Kuvendit Komunal propozojmë z.Betim Merdiu.

z.Hatixha Sheh- Pasi se kemi propozimin për këtë post, paraprakisht, propozoj që të themelojmë Komisionin Zgjedhor prej 3 apo 5 anëtarëve? Nëse është disponimi që Komisioni të ketë 3 anëtarë, të propozojmë 2 nga komuniteti shumicë dhe 1 nga ai jo shumicë?

z.Usmen Ballxhi- Propozoj që Komisioni të ketë 3 anëtarë dhe atë në atë përbërje, siç theksoi edhe parafolësja.

z.Hatixha Sheh- A pajtoheni me këtë propozim...? Miratohet. Prandaj, ju lutem që të propozoni anëtarët...

z.Granit Rifaj- Nga PDK-ja propozoj z.Artan Loshaj.

z.Usmen Ballxhi- Nga "Vakat-i" propozoj z.Zinaida Elmazi.

z.Selami Saiti- Anëtar të 3-të të Komisionit propozoj z.Laurat Krasniqi nga "Vetëvendosje".

z.Hatixha Sheh- Për t'u zbatuar procesi zgjedhor, kërkoj nga Komisioni i posazgjedhur që, në bashkëpunim me Shërbimin e KK-së, të përgatit Fletëvotimet, pasi se sipas nenit 41.3 të LV Lokale votimi bëhet me vota të fshehta, nga secili delegatë, veq e veq dhe propozoj të kemi pauzën 15-minutëshe...

Vazhdojmë me punën e seancës dhe kërkoj nga përfaqësuesi i Komisionit Zgjedhor që të paraqet Raportin reth zgjedhjes...

z.Zinaida Elmazi- Nga 19 delegatë, përkatësisht 19 fletëvotime, 18 vota ishin "pro" dhe 1 votë "kundër", që konstatojmë se, me shumicë, u zdhodh për Kryesues të Kuvendit Komunal të Dragashit z.Betim Merdiu.

z.Hatixha Sheh- Në rregull, i urojmë Kryesuesit të ri dhe, para se të merr kryesimin e mëtejshëm të seancës, propozoj që Kuvendit t'i paraqitet, shkurtimisht, Kryetari deritashëm i Komunës z.Salim Jenuzi dhe Kryetari posazgjedhur i Komunës z.Shaban Shabani.

z.Salim Jenuzi- Ju falminderit! Sot, vërtetë, kam emocione, por ndryshe nga ato para 10 viteve, kur edhe dhash betimin si ju dhe Shabani sot. Prandaj, të gjithë delegatëve të tashëm, sikurse edhe të mëhershmeve u dëshiroj suksese e posaçërisht Kryetarit të ri z.Shaban Shabanit

të cilit i dëshiroj suksese në punë dhe dëshiroj që puna e tij të jetë më e sukseshme se e imja, në atë mënyrë që të jetë njëri ndër kryetarët më të sukseshëm.

z. Shaban Shabani- Kam nderin që të ju paraqitem në rolin e ri të Kryetarit të Komunës së Dragashit dhe ju falënderoj për besimin e dhënë për të udhëhequr Komunën në periudhën vijuese të mandatit 4-vjeçar. Po ashtu, i falënderoj edhe votuesit të cilët kanë menduar ndryshe me rastin e përkrahejs së kandidatëve tjerë në zgjedhjet lokale. Të nderuar, zotohem, para jush, se do të angazhohem për të punuar sipas ligjeve dhe se do të jem i përgjegjshëm dhe transparent, se do të bashkëpunoj ngusht me nivelin e pushtetit qendror, me organizatat venedore e ndërkombëtare, përfshi këtu edhe shoqërinë civile. Në punën time do të kërkoj vazhdimisht përkrahjen tuaj, që edhe me këtë rast e kërkoj atë përkrahje, në mënyrë që, bashkarisht, të angazhohemi për një të ardhme më të mirë, sepse vetëm ashtu mund të kemi një mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët e Komunës sonë.

z. Hatixha Sheh- Njëherësh, ju njoftoj se sipas 54.2 të LV Lokale, zv. i Kryesuesit të KK-së nga komuniteti jo shumicë i cili ka marr më shumë vota në listën e hapur zgjedhore të zgjedhjeve lokale e që në rastin konkret është z. Usmen Ballxhi nga koalicioni "Vakat" të cilin e urojmë, kurse për udhëheqjen e mëtejme të seancës e ftoj Kryesuesin e ri të KK-së z. Betim Merdiu të merr udhëheqjen e seancës. Ju faleminderit.

z. Betim Merdiu- Të nderuar, Ju falënderoj për besimin e dhënë me bindjen dhe porosinë se me angazhimin tim do të jem i përkushtuar në zbatimin e ligjeve, Statutit të Komunës, si dhe të Rregullores së Punës së Kuvendit tonë. Në këtë drejtim, shpresoj se do të përmirësojmë jetesën dhe standardin e qytetarëve tonë, pasi se ne delegatët, në radhë të parë, duhet të jemi në shërbim të tyre. Me Betimin e dhënë, mendoj se do të jemi racional, me besim të ndërsjell, për punë e cila kërkon përgjegjësi për t'u përmbushur nevojat e qytetarëve të cilët na kanë dhënë besimin me rastin e zgjedhjes sonë. Gezuar dhe suksese në punën tonë. Vazhdojmë me punën...

z. Usmen Ballxhi- Dëshiroj t'u falënderohem të gjithë qytetarëve të Komunës së Dragashit, të gjithë juve, mediave, për zgjedhjet e lira e demokratike. Koalicionit "Vakat", me numrin më të madh të votave në komunitetin jo shumicë, i ka takuar vendi i zv. Kryetarit të Komunës sipas LV Lokale dhe dëshiroj të them, përderi sa jam këtu, se do të jap gjithçka nga vetja që të punojmë bashkarisht. Këtu nuk kemi dallime në mes veti, as në baza etnike, fetare e gjeografike, pasi se Dragashi është një komunë e Kosovës e cila duhet t'i dëshmon Kosovës për bashkëjetesën tonë, unitetin, multikulturën dhe qëllimin tonë të përbashkët që, në të ardhmen, të jemi më të mirët. Të gjithë do t'i ndihëmojmë Kryesuesit që seancat tona të janë ndër më të mirat në Kosovë, që si pozita, po ashtu edhe opozita, të kanë të drejtën të shprehin mendimin e tyre, ashtu siç e kërkojnë partitë dhe votuesit tonë që na kanë dhënë votën. Shpresoj se ky Kuvend do të jetë

shembull në Kosovë dhe se, ne nga komuniteti jo shumicë, pasi se na takon vendi i zv.Kryesuesit të Kuvendit, do t'a ndihëmojmë në mënyrën më të mirë të mundëshme, për t'u udhëhequr Kuvendi, për të miratuar aktet që i përkasin Kuvendit, siç janë: rregulloret, aktetet nënligjore, vendimet etj. Shpresoj se ky Kuvend, s' bashku me Kryetarin, do të ketë sukses për partneritet më të frytshëm se kuvenet e mëparshme. Në seancën e I-rë konstituive të Kuvendit në vitin 2000, në zgjedhjet e para demokratike, edhe unë isha anëtar, por dua të besoj se kjo përbërje tani do të jetë më e sukseshme, duke i falënderuar kësaj rinie dhe unitetit i cili duhet të jetë në Kuvend.

z.Betim Merdiu- Vazhdojmë me punën dhe, sipas rendit të ditës që kemi, në radh kemi propozimin dhe zgjedhjen e Nënkyetarit për Komunës, për komunitete, që sipas neni 61 të LV Lokale, propozimi jepet nga Kryetari i Komunës e që duhet të miratohet nga ana e shumicës së delegatëve të Kuvendit që janë prezent e votojnë, si dhe nga anëtarët shumicë të Kuvendit prezent e votojnë, nga komuniteti jo shumicë. Prandaj, ftoj Kryetarin e Komunës z.Shaban Shabani që të jep propozimin...

z.Shaban Shabani- Të nderuar, në bazë të LV Lokale, për Nënkyetar të Komunës nga radha komunitetit jo shumicë propozoj z.Sherif Aga.

z.Betim Merdiu- Pra, kandidati i propozuar është z.Sherif Aga e votimi bëhet në mënyrë të fsheht. Kërkoj nga nga Komisini i Zgjedhor që ishte, që në bashkëpunim me Shërbimin e KK-së, të përgatit Fletëvotimet, kurse ne të bëjmë pauzën 15-minutëshe...

Fillon votimi për Nënkyetarin e Komunës për komunitete, fillimisht, nga radha e komunitetit joshumicë, që ftohen të votojnë, me vota të fshehta...

z.Artan Loshaj- Pas numrimit të votave, nga radhët e delegatëve të komunitetit jo shumicë, nga të cilët prej 7 delegatve që duhetj të votonin, kanë votuar 6 delegatë, prej të cilëve "për" ishin 5 vota dhe 1 votë ishte "kundër" dhe tabni kalojmë në votimin nga radha e delegatëve të komunitetit shumicë... Nga 13 delegatë "për" ishin 12 vota dhe 1 votë ishte "kundër", që konstatoj se votimi kaloi me zgjedhjen e z.Sherif Aga Nënkyetar i Komunës, për komunitete.

z.Betim Merdiu- Pra, sipas votimit, konstatoj se se për Nënkyetar të Komunës,për komunitet, u zgjodh z.Sherif Aga të cilin e ftoj që të merr fjalën.

z.Sherif Aga- Faleminderit të nderuar dhe, fillimisht, dëshiroj të ju uroj të gjithë kandidatëve të Kuvendit shëndetë dhe suksese të reja në punë. Përshëndetje dhe suksese i dëshiroj edhe Kryetarit të ri të Komunës z.Shaban Shabani. Shfrytëzoj rastin që edhe ish-udhëheqësisë së Komunës t'i dëshiroj shëndetë dhe suksese në jetë. Unë po paraqitem si partneri i juaj para subjektit tim politik-"Vakat" dhe, nga kjo foltore, po e paraqes mendimin dhe qëndrimin

tim që mendoj se me këtë përbërje do të jetë kënaqësi dhe gëzim të punohet dhe, e dhasht Zoti që të jemi partner e kurrsesi opozitë dhe, edhe një herë, Ju falënderoj për besimin e dhënë.

z.Betim Merdiu- Edhe një herë të ju përkujtoj se Zv.Kryetarin dhe drejtorët e drejtorateve të Komunës, sipas LV Lokale, i emron Kryetari, që do të bëhet në ndërkohë dhe, me këtë, përfundojmë seancën e sotme të Kuvendit tonë.

z.Usmen Balxhi- Më falni, edhe për diçka po e marr fjalën, pasi se jam zgjedhur me votat e qytetarëve të Dragashit, dhe, për shkak të pozitës që kam në Qeverinë e Republikës së Kosovës, para subjektit tim - "Vakat" i falënderoj të gjithë votuesit që më votuan mua dhe subjektin tim. Por, unë, pas kësaj seance të Kuvendit, Ju njoftoj se do të jap dorheqjen e parevokueshme, nga pozita e delegatit të Kuvendit të KK-së Dragash, por do të apeloja për trajtim të barabartë të gjithëve nga ana e Kryetarit, Kryesuesit dhe zëvendësave, që mos të ketë kurrfar ndasi, kurse, që nga sot, z.Sherif Aga nuk është vetëm "Vakat" por përfaqësues i të gjitha subjekteve në Kuvend dhe i popullatës jo shumicë në Komunën e Dragashit.

z.Betim Merdiu- Ju falënderoj të gjithëve dhe, me këtë, shpalli përfundimin e seancës së sotme-konstituive, të Kuvendit tonë.

E përpunoi:

Shërbimi Profesional i KK-së

Kryesuesit e seancës :

**z.Hatixha Sheh & z.Betim Merdiu**